

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. B. nga Gj., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.2083/2010, të datës 10.12.2010 të cilën e përfaqësonte Prokurorja Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 29.03.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **L. B.**, nga babai N. dhe e ëma S., e lindur A., i lindur ... në P., jeton ..., Rr. ..., Gj., ka të kryer ..., ... punë, ... martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar dhe udhëhiqet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me date2010, në intervalin kohor prej orës ... deri në ... minuta, në Gj., në rrugën “...” afër ndërtesës së kuqe të pandehurit me qëllim të përfitimit të kundëtligjdhshëm pasuror për vete, kanë kryer vjedhje në atë mënyrë që me një kaqavidë dhe duke përdorur forcën kanë hapur derën e pasme të veturës ..., me tabela të regjistrimit ..., pronë e të dëmtuarit R. M. dhe nga vetura kishin vjedhur, një-kasetofon të veturës, një-jakne të lëkurës ngjyrë e zezë, dy-aparate të telefonit fiks-njëri prej tyre panasonik dhe pastaj me sendet e vjedhura ikin në drejtim të pa njohur dhe në këtë mënyrë të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej rreth 500 euro.

me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 43, 45, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

Të akuzuarit L. B., për veprën penale sipas dispozitivit **I** të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë,

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbartimit të dhunshëm

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejtë ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor. Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimin gjyqësor duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë qështje penale. Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 29.03.2016, Prokurorja Rozelida Hasani, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës lëndore, duke i propozuar gjykatës të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas Kodit penal, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese si pranimi, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sjelljen korrekte të tij, ndërsa rrethana

rënduese, shkalla e përgjegjësisë penale, vepra është kryer me dashje, pasojat e shkaktuara dhe i pandehuri është recidivist.

I pandehuri L. B., në fjalën përfundimtare deklaroi: e ndiej vehten fajtor, jam penduar për këtë veprë që e kam kryer, i kërkoi falje të dëmtuarit dhe gjykatës, jam i gjendjes së varfër ekonomike i premti gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe lus gjykatën që të ma shqiptoi një dënim sa ma të butë.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari L. B., ka deklaruar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale e cila më vihet në barrë sipas dispozitivit I të kësaj aktakuze.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit, vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 i KPP, për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike në kuptim të nenit 253 të KPP.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari L. B. nga Gj., me dashje ka kryer veprën penale Vjedhje e rendë, nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata, e shpalli fajtor të akuzuarin L. B. nga Gj., për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje e rendë, nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit L. B., gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP, ku si rrethana lehtësuese, gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykatore, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë; në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në moshë të re, nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë 6 vite, se i akuzuari është penduar; i ka kërkuar falje të dëmtuarit, se i akuzuari ka premtuar gjyqtarit të vetëm gjykues se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale; ndërsa, si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjësisë penale, vepra është kryer me dashje, pasojat e shkaktuara si dhe i njëjti është recidivist.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me burgim prej 7 muaj, ndaj të akuzuarit L. B., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP.

Për arsyet e lartcekura në kuptim të nenit 365 lidhur me nenin 450 të KPPRK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 118/2016, Më 29.03.2016

Sekretarja juridike,

Igballe Azemi d.v

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.